

ME RASTIN E DITËS PËR RUAJTJEN E KRIJIMIT

Vaticani, 24 maj 2020

Të dashur vëllezër e motra në Krishtin,

përshëndetje pashkore nga Roma. Gjatë Vitit të Përvjetorit Special të Letrës Enciklike *Laudato Si'*, Dikasteri për Shërbimin e Zhvillimit Tërësor Njerëzor është i lumtur t'ju ftojë që t'i bashkoheni familjes ekumenike në krenimin e Kohës së Krijimit, takim vjetor që fillon me datën 1 shtator, Dita Botërore e Lutjes për Përkujdesjen ndaj Krijimit, dhe zgjat deri më 4 tetor, Festa e Shën Françeskut të Asizit.

Vitin e kaluar, Ati i Shenjtë Papa Françesku i ka ftuar zyrtarisht besimtarët që të marrin pjesë në këtë “periudhë lutjeje dhe veprimi më të dendur në dobi të shtëpisë sonë të përbashkët”. Siç pohon Ati i Shenjtë: “Kjo është *koha që të rimësojmë të lutemi*”, një kohë “*për të reflektuar mbi stilet tona të jetës*”, një kohë “*për të ndër marrë veprime profetike*”... duke kërkuar që të bëjmë zgjedhje të guximshme... për ta orientuar planetin tonë drejt jetës, në vend që ta çojmë atë drejt vdekjes”.

Mesazhi i Papa Françeskut, që na fton të merremi me atë që është duke vënë në “provë të fortë më të dobët mes nesh”, është veçanërisht i rëndësishëm në dritën e pandemisë së koronavirusit. Ndërsa bota jeton një paqartësi dhe vuajtje të thellë në mes të një emergjence globale, jemi të thirrur që të pranojmë se për të pasur një rifillim me të vërtetë të shëndetshëm duhet të kuptojmë se “gjithçka është e lidhur” dhe t'i rivendosim lidhjet që janë këputur. E kuptojmë mjaft mirë se duhet të rritemi gjithnjë e më shumë në solidaritet dhe të kujdesemi për njëri-tjetrin në vëllazëri.

Të frymëzuar prej Nxitjes apostolike *Querida Amazonia*, inkurajojmë popullin e Hyjit që t'i shpejtojë hapat drejt *ecjesh të reja për Kishën dhe një ekologjie tërësore*, duke planifikuar veprimtari për Kohën e Krijimit. Këto mund të përfshijnë një Meshë të veçantë apo një shtegtim në këmbë, praktika mbrojtëse apo nisma mobilizimi për t'iu përgjigjur britmës së tokës dhe britmës së të varfërve, veprimtari këto që duhen zhvilluar pikërisht në këtë kohë të veçantë.

I inkurajojmë Ipeshkvijtë dhe Institucionet kishtare që të bëjnë deklaratat për një përhapje më të madhe të Kohës së Krijimit, duke i ndihmuar besimtarët që të jenë të vetëdijshëm se “ta jetosh thirrjen për të qenë rojtarë të veprës së Hyjit është pjesë thelbësore e një ekzistence të virtytshme, nuk është diçka opsionale dhe as një aspekt dytësor i përvojës së krishterë” (*Laudato si'*, nr. 217).

Kjo kohë e veçantë na jep mundësinë që të punojmë për ripërtëritjen e Tokës sonë dhe të marrëdhënieve të çmueshme që kemi, si edhe ju ftoj përzemërsisht që t'i bashkoheni krenimit të kësaj kohe. Lutem për ju dhe ju kërkoj që edhe ju të luteni për mua.

Me respekt i juaji në Krishtin

Imzot Bruno-Marie Duffé
Sekretar i Dikasterit për Shërbimin e Zhvillimit Tërësor Njerëzor